# DËSHMI ARKIVI

**A-461472**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Apeli në Hagë/ Avokati britanik tregon si mund të rrëzohen aktgjykimet ndaj ish-krerëve të UÇK-së |
| ADRESA | `https://tpz.al/apeli-ne-hage-avokati-britanik-tregon-si-mund-te-rrezohen-aktgjykimet-ndaj-ish-krereve-te-uck-se-i333591` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 05:02:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 09:54:19 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `73c37365027dff4a514394d85a53582c9f9b249bcc885788488f137c31293ed9` |
| TEKSTI | `48f0227a52a70bb844023a66c7e392af9281900bcec8dd8214ff3145e65f9ca6` |
| PAMJA | `e520bb632bf3af8e4dd12cd41ed6fb2c534aa76b6882bb1be795762d52175916` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bb13c88b247bf445ddf9ae66e876c83a43ea1172ccd351b23bfd694d113171c8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bb13c88b247bf445ddf9ae66e876c83a43ea1172ccd351b23bfd694d113171c8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BALLKAN, 22 SEPTEMBER 2026, 11:54

# Apeli në Hagë/ Avokati britanik tregon si mund të rrëzohen aktgjykimet ndaj ish-krerëve të UÇK-së

tpz.al TPZ




Në një intervistë me gazetarin e Euronews, Xhemajl Rexha, avokati britanik Toby Cadman ka komentuar dënimin e ish-krerëve të UÇK-së nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Cadman, i cili ka përfaqësuar më herët Nasim Haradinajn dhe njeh mënyrën e funksionimit të Speciales, i cilësoi dënimet, veçanërisht ato prej 25 vitesh për Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin, si “shumë zhgënjyese”.

Sa i përket procesit të apelit, Cadman vlerësoi se mbrojtja duhet të fokusohet te mënyra se si janë trajtuar deklarimet e dëshmitarëve të mbrojtjes, duke thënë se kjo mund të argumentohet për të kërkuar rrëzimin e aktgjykimeve.

“Sa i përket apelit, mendoj që duhet të argumentohet shpërfillja e dëshmive të dëshmitarëve të mbrojtjes. Dëshmitë e mbrojtjes janë shpërfillur plotësisht dhe kjo duhet të argumentohet fuqishëm në apel dhe potencialisht të çojë në rrëzimin e aktgjykimeve. Si avokat, kam gjithmonë shpresë dhe besim në institucionet gjyqësore. Një nga gjërat që mezi pres”, tha Toby Cadman.

Sipas tij, fakti që procesi ka ndjekur penalisht vetëm njërën palë të konfliktit ndikon në legjitimitetin e institucionit, ndërsa theksoi se Specialja është një tribunal ndërkombëtar në çdo aspekt, përveç emrit.

“Reagimi im i parë ishte se kjo ishte një formë e pritshme, por është shumë zhgënjyese, sidomos shkalla e lartë e dënimit. Është kohëzgjatje shumë e madhe e dënimit, sidomos për Thaçin dhe Krasniqin, që u dënuan me 25 vjet. Kur një proces është ngritur për të ndjekur penalisht vetëm njërën palë të konfliktit, veçanërisht palën që ka vuajtur më së shumti, kjo ndikon në legjitimitetin e institucionit. Mendoj se një shqetësim tjetër është që vendimi jepet në emër të popullit të Kosovës. Kjo ka shkaktuar shqetësim të madh dhe po shohim lëvizje me sloganin ‘Jo në emrin tim’. Është e vështirë që kjo të barazohet me një gjykatë të Kosovës. Ky është një tribunal ndërkombëtar në çdo aspekt, përveç emrit”, tha Cadman.

ide!

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë
Nga Preç Zogaj

Vendimi i Gjykatës Speciale rrëzoi arsyet për të cilat ajo ishte ngritur
Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Sa i përket hapave të mëtejshëm, Cadman tha se ndryshimi i ligjit për Specialen do të ishte i vështirë për shkak të presionit ndërkombëtar, ndërsa përmendi mundësinë që procedurat e apelit të zhvillohen në Kosovë. Ai argumentoi se ligji nuk e përjashton një mundësi të tillë dhe se do të ishte e preferueshme që proceset të zhvilloheshin në vendin ku kanë ndodhur ngjarjet.

[Shiko të tjera video](#)

"Kemi parë deklarata të shumta për ndryshimin e Speciales dhe mendoj për amendimin e ligjit, por mendoj se është shumë e vështirë që tani të ketë ndryshime. Një nga kritikat kryesore buron nga fakti se Specialja nuk ka asnjë lidhje me Kosovën, nuk ka koordinim me ministritë apo institucionet e Kosovës. Nëse shohim përpjekjet për reformën para disa vitesh, kishte një lëvizje në Kuvend për ta shqyrtuar institucionin dhe për të parë mundësinë për reformimin e ligjit. Autoritetet e Kosovës nuk kishin kompetencë për të bërë ndryshime dhe ndërkombëtarët ishin kritikë ndaj çdo përpjekjeje për të ndryshuar këtë proces. Mendoj se edhe tani do të ishte i njëjti presion nga BE-ja dhe SHBA-ja. Vetëm BE-ja do të kishte autoritet për ta bërë. Marrëveshja e shtetit pritës është një marrëveshje ndërkombëtare. Ajo ka një klauzolë ku Kosova potencialisht mund ta paraqesë një kërkesë në arbitrazh. Potencialisht është diçka që mund të konsiderohet tani nga autoritetet shtetërore.

Si marrëveshje ndërkombëtare, është mes Kosovës dhe Holandës, që ka të bëjë me shtetin pritës. Me faktin që institucioni ndodhet në Hagë, jashtë Kosovës, janë bërë komente që procedurat e apelit të bëhen në Kosovë. Aktualisht nuk ka asgjë që e ndalon këtë, sepse ligji thotë se selia është në Kosovë dhe diku tjetër; ai nuk thotë se procedurat nuk mund të zhvillohen dhe të mbahen në Kosovë. Edhe unë kam thënë që është e preferueshme që kjo gjë të bëhet në vendin ku kanë ndodhur ngjarjet. Kosova, në të vërtetë, nuk ka ndonjë fuqi për t'i kërkuar institucionit dhe BE-së, por ama nuk ka asgjë që ta pengojë zhvillimin e seancave në Kosovë. Unë e kam mbështetur këtë edhe për arsyen se gjykata nuk ka qasje nga populli i Kosovës", tha ai.

BALLKAN / 21 September 2026, 22:34

## Për të gjashtën natë, qytetarët protestojnë në Prishtinë kundër aktgjykimit të Speciales

BALLKAN / 21 September 2026, 22:15

## Avokati i Thaçit: Tre Gjykatësit e Speciales njollosën UÇK-në dhe NATO-n

BALLKAN / 21 September 2026, 21:32

## Hill flet për pasojat nëse Kosova kërkon të zhbëjë Gjykatën Speciale të Hagës

BALLKAN / 21 September 2026, 20:55

## Plagosi veten që t'i shpëtonte policisë, 27-vjeçari pranon vrasjen e ish të dashurës në Greqi

BALLKAN / 21 September 2026, 20:43

Çitaku: Nëse LVV e voton ndryshimin e Ligjit për Specialen, PDK është e gatshme të tërheqë padinë nga Gjykata Kushtetuese

BALLKAN / 21 September 2026, 19:38

PDK propozoi ligjin për ndryshimin e Gjykatës Speciale pas vendimit në Hagë, reagon Vetëvendosje

BALLKAN / 21 September 2026, 19:16

Zgjedhjet në Serbi/ Lëvizja e protestave del e para në disa sondazhe, Vuçiç përballë një beteje vendimtare

BALLKAN / 21 September 2026, 17:00

Vala e të ftohtit pritet të përfshijë Ballkanin, meteorologët: Temperaturat do të bien deri në 15 gradë

BALLKAN / 21 September 2026, 16:42

Vritet me thikë 15-vjeçari në Gjermani, në kërkim shqiptari nga Kosova

BALLKAN / 21 September 2026, 15:36

Kurti, mbrojtje "teknike" Thaçit/ Kryeministri nga SHBA, zbut tonet "patriotike"

BALLKAN / 21 September 2026, 14:02

Studentët e Prishtinës marshim protestë: Të lirohen ish-krerët e UÇK-së, vendimi i Hagës padrejtësi!

BALLKAN / 21 September 2026, 12:35

"Vëllanë ma vranë"/ Motra e këngëtarit të ndjerë, Giorgos Mazonakis: Jam shumë e zemëruar

BALLKAN / 21 September 2026, 12:19

## Dënimi i liderëve të UÇK-së, PDK çon në Kuvend nismën për ndryshimin e ligjit për Gjykatën Speciale

BALLKAN / 20 September 2026, 21:03

## Prapaskenat e Speciales, Hoxhaj: Nëse nuk e themelonim ne, do ta bënte OKB-ja me votën e Rusisë dhe Kinës

BALLKAN / 20 September 2026, 20:58

## Flamuri gjigant kuq e zi shpaloset në protestën në Prishtinë për ish-krerët e UÇK-së

BALLKAN / 20 September 2026, 19:23

## Ish-zyrtari amerikan: Dënimi i Thaçit s'e ndryshon pozitën ndërkombëtare të Kosovës, ai do të kujtohet për udhëheqjen e vendit drejt pavarësisë

BALLKAN / 20 September 2026, 16:26

## Kush është Konstantin Kosachev, rusi që inicioi mocionin që çoi te raporti i Dick Marty-t për Gjykatën Speciale

BALLKAN / 20 September 2026, 15:14

## Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, kryeministri Kurti: Duhet koordinim shtetëror dhe diplomatik për të ndryshuar vendimin

BALLKAN / 20 September 2026, 12:20

## Pas 27 vitesh, identifikohet Idriz Rrecaj, një nga 23 viktimat e "Grupit të Intelektualëve" në Kosovë

BALLKAN / 19 September 2026, 22:59

## Mbrojtja përgatit Apelin ndaj aktgjykimit të krerëve të UÇK-së, rasti Gotovina ngjall shpresë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.